

## **E DREJTA E PËRFAQËSIMIT**

### **Neni 17**

1. Sipas kushteve të përcaktuara në nenin 89(2), çdo person mund të caktojë një përfaqësues të vetin për marrëdhëniet me autoritetet doganore, për të kryer veprimet e për të përmbushur formalitetet e parashikuara nga legjislacioni doganor.
2. Ky përfaqësim mund të jetë:
  - a) i drejtpërdrejtë, kur përfaqësuesi vepron në emër e për llogari të një personi tjetër; ose
  - b) i tërthortë, kur përfaqësuesi vepron në emër të tij, por për llogari të një personi tjetër.
3. Përveç rasteve të përmendura në nenin 89(2) (b) dhe (3), përfaqësuesi duhet të jetë i vendosur në Republikën e Shqipërisë.
4. Përfaqësuesi duhet të deklarojë se vepron për llogari të personit të përfaqësuar, të specifikojë nëse përfaqësimi është i drejtpërdrejtë ose i tërthortë dhe nëse ka të drejtën të veprojë si përfaqësues.
5. Autoritetet doganore i kërkojnë çdo personi që deklaron se vepron në emër dhe për llogari të një personi tjetër, të paraqesë dokumente që provojnë se i është dhënë e drejta të veprojë si përfaqësues.
6. Përfaqësues, sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen, mund të jetë edhe agjenti doganor i licencuar si i tillë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Kushtet për lëshimin dhe revokimin e licencës përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.